Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kuvendi Komunal, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Zgjerimi, konsolidimi dhe rikofigurimi i Stadiumit "Perparim Thaçi" , Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.12.2026 në ora 10:00 ne Sallën e Shtëpisë se Bardhë te Komune së Prizrenit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://zoom.us/j/95484740833?pwd=HfaZ7B3AROQQXnJFMEhZBh4CfZ5oSi.1

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "për Zgjerimi, konsolidimi dhe rikofigurimi i Stadiumit "Perparim Thaçi" , Prizren.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS- Zgjerimi, konsolidimi dhe ri konfigurimi I Stadiumit "Përparim Thaqi" Prizren

Investitor: MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Nr. Parcelës: 11810-0 ZK Prizren

Vendi: Prizren

DHJETOR, 2024

ZGJERIMI, KONSOLIDIMI DHE RIKONFIGURIMI I STADIUMIT "PËRPARIM THAQI" PRIZREN

Investitori	**Ministria E Kulturës, Rinisë Dhe Sportit**
Vendi	Zona kadastrale Prizren
Nr. I Parcelës	11810-0 ZK Prizren

Hartues	**Msc. Lum Beqiraj**
Nr. Licencës	15/20
Vendi	Prishtinë
Email:	lumbeqiraj@gmail.com
Nr. tel	+38344174253

Nënshkrimi:

Në bazë të kërkesës për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin **"Zgjerimi, Konsolidimi dhe Rikonfigurimi i Stadiumit 'Përparim Thaqi'"** në Prizren, investitori **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit** autorizon **Msc. Arch Lum Beqiraj**, i licencuar për hartimin e raporteve të VNM-së, për të realizuar këtë detyrë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MEA lëshon:

Nr. i licencës: 15/20

LICENCË

z. Lum Beqiraj, Master i Shkencave teknike

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-ës

Data e vlefshmërisë:
27.10.2020— 27.10.2025
Prishtinë

Blerim Kuçi
Ministër i MEA

PËRMBAJTJA

1. HYRJA 7
2. BAZA LIGJORE 8
2.1 Rregullativa ligjore 8
3. METODOLOGJIA E PUNËS 9
4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT 11
4.1 Zhvillimi Hapësinor përreth Stadiumit 12
4.2 Qasja 13
4.3 Gjendja Fizike dhe Infrastruktura Ekzistuese 13
4.4 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të terrenit e të mjedisit 14
5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT NË RAJONIN E PRIZRENIT 15
5.1 Problemet Mjedisore Kryesore 16
5.2 Ndotësit Kryesorë 17
6. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK 17
6.1 Karakteristikat Kyçe të Dizajnit: 19
6.2 Materialet dhe Instalimet për Stadiumin "Përparim Thaqi" në Prizren 21
7. NDIKIMET E IDENTIFIKUARA MJEDISORE DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E NDIKIMEVE 21
7.1 Ndikimet në cilësinë e ajrit 21
7.2 Ndikimet nga zhurmat dhe vibrimet 22
7.3 Ndikimet në peizazh 23
7.4 Ndikimet në Ujërat Nëntokësore dhe Sipërfaqësorë: 23
7.5 Ndikimet në Florë dhe Faunë 24
7.6 Ndikimet në Vendbanime dhe Popullatë: 24
8. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE MJEDISORE 25

8.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër 25
8.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë 26
8.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë 26
8.4 Masat për mbrojtje nga zhurma 26
8.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë 28
8.6 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë 29
8.7 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore 30
8.8 Menaxhimi i mbeturinave 30
9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI 31
9.1 Monitorimi 31
9.2 Raportimi 31
10. PËRFUNDIM 32
11. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE 33
12. LITERATURA 34

LISTA E FIGURAVE, HARTAVE DHE TABELAVE.

Figura 1. Lokacioni i Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren në raport me rrethinën.. 11
Figura 2. Pamja Aktuale e Fushës dhe Tribunës së Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren. 12
Figura 3. Fushës dhe ne prapavije objektet kolektive prane Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren. 13
Figura 4. Për të siguruar një përvojë më të mirë për vizitorët e stadiumit, parkingu ekzistues pranë stadiumit do të ristrukturohet plotësisht. Kjo do të përfshijë rishënimin e vendeve të parkimit, me qëllim të përmbushjes së të gjitha standardeve të sigurisë dhe aksesibilitetit. 14
Figura 5. Situacioni i kompleksit dhe qasjet për persona dhe veturat.....18
Figura 7. Prerja e stadiumit të strukturës ekzistuese dhe elementëve të rinj që do të ndërhyhet gjatë fazës së zgjerimit, konsolidimit dhe rikonfigurimit. Kjo përfshin hapësirat kryesore të tribunave, hyrjet dhe daljet për spektatorët, si dhe sistemet ndihmëse si parkingjet dhe infrastruktura teknike. 20
Figura 9. Mbrojtja nga zhurma.....27
Figura 8. Në Kosovë mbi ndotjen akustike vepron ligji Nr. 02/L-102, i cili referuar standardeve të BE-së përcakton se norma e lejuar e zhurmës gjatë ditës është 55 decibel dhe gjatë natës 35 decibel. 28
Figura 10. Llojet e gjelbërimit qe mund te vendosen ne kompleks pas përfundimit te ndërtimit.....29

Harta 1. Parcelat ku ndodhet stadiumi dhe që do të trajtohet gjatë projektit të zgjerimit, konsolidimit dhe rikonfigurimit.....15
Harta 2. Shfrytëzimi i tokës në Qendër të Qytetit (Analiza Prill 2009) PZHU 2013-2025.....16
Tabela 1. Vlerat mesatare mujore të ajrit ne Prizren sipas raportit vjetor për gjendjes se ajrit 2023. 22

1. HYRJA

Objektivi kryesor i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin e propozuar të zgjerimit dhe rikonfigurimit të Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedisin e Republikës së Kosovës. Ky raport synon të sigurojë që realizimi i projektit të jetë i qëndrueshëm, duke ruajtur integritetin e mjedisit dhe duke respektuar standardet ligjore dhe teknike në fuqi.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) ofron një nivel të lartë mbrojtjeje përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative të projekteve, qoftë publike apo private, në mjedis. Ky raport përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve, me qëllim parandalimin ose zvogëlimin e tyre. Si një dokument ligjërisht i domosdoshëm, ai përbën bazën për marrjen e pëlqimit mjedisor nga autoritetet përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), kusht ky i nevojshëm për fillimin e punimeve të zgjerimit, konsolidimit dhe rikonfigurimit të stadiumit.

Në Raportin e VNM-së analizohen në mënyrë të detajuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitet, si dhe karakteristikat teknike të punimeve të planifikuara për projektin. Në këtë mënyrë, identifikohen të gjitha ndikimet relevante që mund të shfaqen në mjedisin jetësor dhe më gjerë nga realizimi i veprimtarisë së propozuar.

Hartimi i këtij raporti bëhet në mënyrë transparente, duke paraqitur qartë ndikimet e mundshme mjedisore të projektit, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e mjedisit dhe minimizimi i efekteve negative. Raporti mbështetet në dokumentacionin teknik ekzistues, në karakteristikat specifike të lokacionit, si dhe në gjendjen aktuale të mjedisit përreth.

Detyra kryesore e këtij raporti është identifikimi i burimeve të ndotjes, vlerësimi i ndikimeve të tyre në mjedis, si dhe propozimi i veprimeve për parandalimin ose së paku zvogëlimin e këtyre ndikimeve brenda kufijve të lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet e dala nga ky raport duhet të merren parasysh gjatë fazës së ndërtimit, operimit të stadiumit dhe pas përfundimit të veprimtarisë, me qëllim mbrojtjen e vazhdueshme të mjedisit.

2. BAZA LIGJORE

Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis përfshinë identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjate ndërtimit te këtij objekti me afarizëm siç janë:

- Identifikimi i burimit qe rrezikon mjedisin.
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis,
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin deri ne kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

Me rastin e hartimit te Raportit te VNM -se per Zgjerimi, konsolidimi dhe rikonfigurimi I Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren, jane marre per baze ligjet me te rendesishme te aplikuara si:

- Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/I-181 per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (2023)
- Ligji per mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji per Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) per ndryshim dhe plotesimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) per mbeturina
- Ligji Nr. 08/L-145 per Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar te Ndotjes
- Ligji per ujerat e Kosoves Nr. 04/L-147
- Ligji per planifikim hapesinor Nr. 04/L-174
- Ligji per ndertim Nr. 04/L-110
- Ligji per token bujqesore Nr. 02/L- 26
- Ligji per mbrojtjen e natyres Nr. 03/L-233
- Ligji Nr. 03/L-120 per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit per rruge Nr. 2003/11
- Ligji per mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-1027
- Ligji per mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji për Efikasitetin e Energjisë Nr. 06/L-079
- Ligji për sport Nr. 08/I-277
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzim Administrativ Nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet , mënyrat ,parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit te ujerave te ndotura ne rrjetin e kanalizimit publik dhe trupin ujor.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

Realizimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), si dhe identifikimi dhe propozimi i masave për parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve në mjedis për projektin "Zgjerimi, konsolidimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit 'Përparim Thaqi'" në Komunën e Prizrenit, është bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse të vlerësimit për projekte të ngjashme. Ky vlerësim është kryer në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet mjedisore. Projekti përfshin parcelat kadastrale nr. 0279-0; 04353-0; 04354-0; 04356-0; në zonën kadastrale të Prizrenit dhe është ndjekur një analizë e detajuar për identifikimin e ndikimeve potenciale sipas fazave të zbatimit.

Përshkrimi i kushteve ekzistuese mjedisore është bërë duke marrë parasysh aspektet e mëposhtme:

- Pozita gjeografike e lokacionit.
- Topografia e lokacionit.
- Biodiversiteti në lokacion.
- Karakteristikat pedologjike (tokësore).
- Shfrytëzimi aktual i tokës.
- Hidrologjia në lokacion.
- Kushtet klimatike dhe të dhënat meteorologjike.
- Kualiteti i ajrit.
- Erozioni dhe rreziku nga vërshimet.
- Zonat e mbrojtura natyrore.
- Popullsia dhe vendbanimet në afërsi.
- Infrastruktura ekzistuese.

Pas analizës së detajuar të gjendjes ekzistuese mjedisore dhe specifikimeve teknike të projektit, janë identifikuar ndikimet potenciale si më poshtë:

- Ndikimet në cilësinë e ajrit.
- Ndikimi në mjedisin ujor.
- Ndikimet në tokë.
- Ndikimet nga gjenerimi i mbeturinave.
- Ndikimi nga zhurma.
- Ndikimet në biodiversitet.
- Ndikimet në peizazh.

- Ndikimet sociale.
- Siguria dhe shëndeti në punë.
- Ndikimet në trashëgiminë kulturore.

Për secilin ndikim të identifikuar janë parashikuar masa për zbutje, minimizim dhe kontroll, të cilat janë përfshirë në Planin e Monitorimit Mjedisor. Ky plan ka për qëllim:

- Monitorimin e burimeve kryesore të ndikimeve në mjedis.
- Sigurimin e implementimit të masave zbutëse për minimizimin e ndikimeve.
- Ruajtjen e biodiversitetit dhe komponentëve të tjerë mjedisorë në lokacionin e projektit.
- Elementët Kryesorë të Analizës dhe Vlerësimit
- Popullata dhe vendbanimet në zonën e projektit.
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi.
- Klima dhe të dhënat meteorologjike.
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve të tjerë mjedisorë.
- Biodiversiteti në lokacion.
- Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kritereve:
    - Gjendja ekzistuese e mjedisit në lokacion.
    - Lloji dhe madhësia e ndotjes së pritshme nga projekti.
    - Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës.
    - Përhapja e mundshme e ndotjes dhe ndikimi në afatgjatë.

Bazuar në rezultatet dhe të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve, janë përcaktuar masa konkrete për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis. Këto masa synojnë ruajtjen e ekuilibrit mjedisor dhe minimizimin e ndikimeve në biodiversitet, infrastrukturë dhe cilësinë e jetës së popullatës lokale.

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT

Stadiumi "Përparim Thaqi" është një arenë sportive e vendosur në qytetin e Prizrenit, në një lartësi mbidetare prej 455 metrash. Stadiumi shtrihet në parcelën kadastrale me numër 11810-0 në zonën kadastrale të Prizrenit.




Figura 1. Lokacioni i Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren në raport me rrethinën..

Lokacioni i stadiumit është pjesë e një zone urbane të zhvilluar dhe të integruar në strukturën e përgjithshme të qytetit. Prania e bizneseve dhe hapësirave publike pranë stadiumit e bën këtë zonë një pikë të rëndësishme për ngjarje sportive dhe sociale.

Fusha dhe tribunat e stadiumit "Përparim Thaqi" pasqyrojnë një strukturë funksionale, por me nevojë për modernizim dhe zgjerim për t'u përshtatur me kërkesat bashkëkohore dhe standardet ndërkombëtare. Fusha e lojës ka dimensionet standarde prej 68x105 metra, e cila përdoret për aktivitete sportive dhe ndeshje futbolli të ligave kombëtare dhe lokale.



Figura 2. Pamja Aktuale e Fushës dhe Tribunës së Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren.

Tribunat e stadiumit janë të vendosura kryesisht në anën perëndimore dhe lindore, me kapacitete të kufizuara për shikuesit, duke ofruar mbulim të pjesshëm. Aktualisht, hapësirat për spektatorët, sportistët dhe VIP-at janë të kufizuara dhe nuk plotësojnë standardet e UEFA-s dhe FIFA-s për ngjarje ndërkombëtare. Tribunat dhe infrastruktura ndihmëse kërkojnë përmirësime për të ofruar akses më të mirë dhe kushte të përshtatshme për të gjitha grupet e përdoruesve.

4.1 Zhvillimi Hapësinor përreth Stadiumit

Territori përreth stadiumit është i karakterizuar nga zhvillimi i shumëllojshëm urban, duke ofruar akses të plotë dhe lidhje të qëndrueshme me mjedisin përreth:

- **Në veri:** Ndodhen shtëpi private dhe një kompleks banesor, ndërsa pranë tij rrjedh lumi Lumbardhi, i cili shton bukurinë natyrore të zonës.
- **Në lindje:** Zona përfshin ndërtesa arsimore, duke përfshirë Qendrën e Kompetencës dhe disa shtëpi private, që e bën këtë zonë të përshtatshme për zhvillime edukative dhe sociale.
- **Në perëndim:** Prania e bizneseve të ndryshme dhe kompleksi universitar "Ukshin Hoti" krijon një lidhje të fortë midis stadiumit dhe aktiviteteve edukative dhe ekonomike të qytetit.
- **Në jug:** Stadiumi kufizohet me parkun e qytetit, duke ofruar një mjedis të gjelbër dhe relaksues për vizitorët dhe spektatorët.



Figura 3. Fushës dhe ne prapavije objektet kolektive prane Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren.

4.2 Qasja

Stadiumi "Përparim Thaqi" ndodhet në zonën urbane të Prizrenit, me akses të lehtë nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese rrugore. Pikat kyçe të qasjes përfshijnë:

- **Nga jugu:** Hyrja kryesore është përmes rrugës "Luan Haradina," që ofron një rrugë të gjerë dhe të mirëmbajtur për vizitorët dhe automjetet.
- **Nga veri dhe jug:** Akses shtesë është siguruar përmes rrugës "Hoxhe Tasimi," që lidhet drejtpërdrejt me zonën qendrore të qytetit.
- **Nga perëndimi:** Stadiumi lidhet me parkun e qytetit, duke e bërë të lehtë qasjen për këmbësorët dhe duke ofruar një ambient të qetë për aktivitetet sportive dhe rekreative.

4.3 Gjendja Fizike dhe Infrastruktura Ekzistuese

Hapësira aktuale përfshin fushën e lojës, tribunat ekzistuese (perëndimore dhe lindore), një fushë ndihmëse (aktualisht jofunksionale) dhe ndërtesat përcjellëse. Fusha kryesore është me dimensione që plotësojnë standardet e UEFA-s dhe FIFA-s. Tribunat ekzistuese janë të ndërtuara nga betoni i armuar, me kapacitete që aktualisht nuk përmbushin kërkesat për evente të mëdha ndërkombëtare. Rrjeti rrugor, parkimet dhe qasjet për këmbësorët janë funksionale, por kërkojnë përmirësime për të siguruar përmbushjen e standardeve të larta të qasjes dhe sigurisë.



Figura 4. Për të siguruar një përvojë më të mirë për vizitorët e stadiumit, parkingu ekzistues pranë stadiumit do të ristrukturohet plotësisht. Kjo do të përfshijë rishënimin e vendeve të parkimit, me qëllim të përmbushjes së të gjitha standardeve të sigurisë dhe aksesibilitetit.


4.4 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të terrenit e të mjedisit

Prania e lumit Lumbardhi në veri të stadiumit dhe parkut të qytetit në jug ofrojnë një lidhje natyrore dhe estetikisht të këndshme për zonën. Këto hapësira gjelbëruese kontribuojnë në cilësinë e mjedisit përreth stadiumit.

Terreni përreth përfshin disa elementë natyrorë, përfshirë pemë dhe shkurre, të cilat mund të preken gjatë procesit të ndërtimit, duke kërkuar masa për rikuperimin e tyre pas përfundimit të projektit. Gjelbërimi ekzistues është i ulët dhe i egër që është i egër për shkak mos mirëmbajtjes së hapësirës. Në rrethine ka një përzierje të ndërtimeve ekonomike, komplekse banimi dhe individuale.

Në bazë të studimeve qe ekzistojnë për këtë zone ku do ndërtohet ky kompleksin shumë-banesor me afarizëm është konstatuar një numër i vogël i llojeve bimore. Përreth ka vetëm bime te kultivuara. Andaj në zonën ku parashihet zgjerohet kompleksi i stadiumit nuk ka ndonjë botë të rrallë endemike bimore apo shtazore.

Gjithashtu në bazë të dhënave nga Agjencia e Mbrojtjes se Mjedisit te Kosovës në këtë zonë nuk kemi ndonjë zonë të mbrojtur.




Harta 1. Parcelat ku ndodhet stadiumi dhe që do të trajtohet gjatë projektit të zgjerimit, konsolidimit dhe rikonfigurimit.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT NË RAJONIN E PRIZRENIT

Prizreni është një nga qytetet më të vjetra dhe më të rëndësishme të Kosovës, i njohur për karakterin e tij të veçantë urban dhe arkitektonik. Ky qytet pasuron trashëgiminë kulturore të vendit me vlera të larta estetike, shpirtërore, shkencore dhe ekonomike, duke qenë një simbol i harmonisë ndërmjet kulturës, historisë dhe natyrës. Prizreni, me përzierjen e tij unike të kulturës, historisë dhe arkitekturës, është një qendër kulturore dhe turistike e rëndësishme për Kosovën, duke ofruar një pasuri të jashtëzakonshme për studiuesit, vizitorët dhe komunitetin vendas.

Kombinimi unik i peisazheve urbane dhe natyrore të Prizrenit kontribuon në karakterin e tij të veçantë. Vendndodhja piktoreske e qytetit, e kornizuara nga malet madhështore, nxit një lidhje të fortë midis ambientit të ndërtuar dhe natyrës përreth. Lumi që rrjedh në zemër të qytetit shërben si një qendër kulturore, duke pritur një larmi ngjarjesh dhe aktivitetesh, veçanërisht gjatë muajve të verës. Kjo bashkëjetesë harmonike e zhvillimit urban dhe elementeve natyrore e dallon Prizrenin nga qytetet e tjera në Kosovë dhe rajon.

Në Komunën e Prizrenit, ashtu si në të gjithë Kosovën, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioriteteve të politikbërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve, qoftë në nivelin lokal apo qendror. Bazuar në hulumtimet dhe vlerësimet e kryera, Komuna e Prizrenit përballet me një sërë problemesh mjedisore që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe efektive.



Harta 2. Shfrytëzimi i tokës në Qendër të Qytetit (Analiza Prill 2009) PZHU 2013-2025

5.1 Problemet Mjedisore Kryesore

Mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm mbetet një sfidë për zonat rurale të komunës, ndërkohë që qendra e Prizrenit tashmë disponon një impiant modern për trajtimin e ujërave të ndotura.

Shumë fshatra vuajnë mungesën e trajtimit të ujërave të zeza, duke shkaktuar ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësore. Menaxhimi jo i duhur i mbeturinave urbane përbën një problem madhor, duke shkaktuar ndotje vizuale, toksike dhe biologjike. Urbanizimi i pakontrolluar dhe ndërrimi i destinacionit të shfrytëzimit të tokës kanë reduktuar sipërfaqet e tokave pjellore.

Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve dhe prerja e pyjeve: Eksploatimi i pakontrolluar i inerteve dhe prerja masive e pyjeve, pa rikuperim dhe ripyllëzim të qëndrueshëm, kanë shkaktuar dëme të mëdha ekologjike dhe ndotje të ujërave dhe tokës.

- Hapësirat e gjelbëruara: Qyteti i Prizrenit përballet me hapësira të pamjaftueshme të gjelbëruara dhe mungesë të infrastrukturës për rekreacion dhe ajrim të mjaftueshëm.
- Monitorimi i mjedisit: Mungesa e një sistemi funksional të monitorimit të ajrit, tokës dhe ujërave bën të pamundur adresimin efektiv të ndotjes dhe zbatimin e masave korrigjuese.

5.2 Ndotësit Kryesorë

Përdorimi i drurit për ngrohje është një ndër kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor (PM2.5) në Komunën e Prizrenit. Ky lloj ndotjeje përfshin emetime të pluhurit grimcor, karbonit të zi, hidrokarboneve poli-aromatike dhe dioksinave. Për më tepër, zjarri nga druri lëshon okside azoti dhe monoksid karboni, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e popullatës.

Në Kosovë, zjarri nga druri përdoret kryesisht në sektorin e banimit dhe përbën rreth 20% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Sipas përllogaritjeve të GAINS, sektori i banimit kontribuon me gati 50% të emetimeve të pluhurit grimcor PM2.5 dhe 80% të emetimeve të karbonit të zi në vitin 2015.

Komuna e Prizrenit nuk disponon një sistem të ngrohjes qendrore, duke bërë që shumica dërrmuese e banorëve të mbështeten në drurin si burim kryesor për ngrohje, veçanërisht gjatë periudhës së dimrit. Nga 28,682 objekte banimi në komunë, 26,070 prej tyre përdorin drurin për ngrohje, ndërsa vetëm 2,061 familje përdorin energjinë elektrike. Në një masë më të vogël, përdoren edhe thëngjilli, nafta dhe gazi natyror. Kjo situatë shkakton ndotje të konsiderueshme të ajrit, duke ndikuar negativisht në shëndetin e popullatës dhe në mjedisin e përgjithshëm.

6. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE PROCESIT TEKNOLOGJIK

Stadiumi i propozuar është një infrastrukturë sportive moderne, e projektuar me kujdes për të përmbushur standardet rigoroze të FIFA-s dhe UEFA-s. Me një kapacitet prej 7,750 spektatorësh, ky vend është gati të bëhet një pikë fokale për komunitetin, duke pritur një gamë të gjerë ngjarjesh sportive, nga ndeshjet e ligës lokale deri në konkurse ndërkombëtare.

Në zemër të stadiumit shtrihet një fushë futbolli e pastër, me përmasa 68 x 105 metra, duke ofruar sipërfaqen ideale për konkurrencë të nivelit të lartë. Fusha është plotësuar nga një tendë e mbuluar plotësisht, e cila siguron kushte optimale shikimi për spektatorët, pavarësisht nga klima. Nën tribuna, infrastruktura moderne, duke përfshirë sisteme të avancuara kullimi dhe teknologji ndriçimi të përparuara, garanton një sipërfaqe loje që vazhdimisht përmbush standardet profesionale.

Dizajni i stadiumit vendos një theks të fortë në përvojën e tifozëve. Vendndodhjet e shkallëzuara me pamje të shkëlqyera sigurojnë që çdo spektator të ketë një pamje kryesore të aksionit. Hapësira e bollshme për këmbët dhe ulëset komode krijojnë një atmosferë të mirëpritur për tifozët të shijojnë lojën. Për të përmirësuar aksesibilitetin, stadiumi përfshin rampa, ashensorë dhe zona të dedikuara ulëse për individët me aftësi të kufizuara.




Figura 5. Situacioni i kompleksit dhe qasjet për persona dhe veturat.

Pas skenave, stadiumi është i pajisur me një gamë të gjerë të faciliteteve për të mbështetur atletët, zyrtarët dhe mediat. Hyrje të ndara për lojtarët, VIP-të dhe publikun e përgjithshëm racionalizojnë aksesin dhe minimizojnë bllokimin. Zona të dedikuara parkimi për ekipet, mediat dhe spektatorët janë

të vendosura strategjikisht për të lehtësuar arritjen dhe largimin e lehtë. Dizajni i stadiumit gjithashtu përfshin masa të forta sigurie, duke përfshirë sisteme monitorimi dhe dalje emergjente, për të siguruar sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve.

Përtej funksionit të tij kryesor si një vend sportiv, stadiumi është parashikuar si një qendër dinamike komunale. Sheshi përreth ofron hapësirë të mjaftueshme për mbledhje para ndeshjes, festime pas ndeshjes dhe ngjarje komunale. Kjo integrime e sportit dhe komunitetit nxit një ndjenjë përkatësie dhe krenarie.




Figura 6. Planimerit e projektit, Projekti për zgjerimin, konsolidimin dhe rikonfigurimin e Stadiumit "Përparim Thaqi" është hartuar për të përmirësuar funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe estetikën e tij, duke e përshtatur me standardet ndërkombëtare të UEFA-s për Kategori II Plus.

6.1 Karakteristikat Kyçe të Dizajnit:

- **Dizajn i Qëndrueshëm:** Duke përfshirë materiale miqësore me mjedisin dhe praktika për të minimizuar ndikimin mjedisor të stadiumit.

- **Vendndodhje Fleksibël:** Aftësia për të rikonfigurim vendndodhjet për të akomoduar një larmi ngjarjesh, nga koncertet deri në konferenca.
- **Përfshirje e Përmirësuar e Tifozëve:** Elemente interaktive, siç janë ekranet e mëdha video dhe aplikacionet mobile, për të përmirësuar përvojën e tifozëve.
- **Teknologji e Ardhshme:** Integrimi i teknologjisë inteligjente për të mundësuar operacione efikase dhe për t'u ofruar tifozëve një përvojë të lidhur.




Figura 7. Prerja e stadiumit të strukturës ekzistuese dhe elementëve të rinj që do të ndërhyhet gjatë fazës së zgjerimit, konsolidimit dhe rikonfigurimit. Kjo përfshin hapësirat kryesore të tribunave, hyrjet dhe daljet për spektatorët, si dhe sistemet ndihmëse si parkingjet dhe infrastruktura teknike.

6.2 Materialet dhe Instalimet për Stadiumin "Përparim Thaqi" në Prizren

Zgjedhja e materialeve për rikonfigurimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Përparim Thaqi" është bërë në përputhje me kërkesat statike, termike, akustike, higjienike dhe ekologjike, duke respektuar normat vendore dhe, kur këto mungojnë, ato të Bashkimit Evropian (BE) për cilësinë e materialeve ndërtimore. Gjithashtu, është marrë në konsideratë efikasiteti i energjisë si një komponent thelbësor në përzgjedhjen e materialeve.

Përpara fillimit të punëve janë marrë të gjitha masat dhe lejet në lidhje me ekzistimin e instalimeve nëntokësore, p.sh. Kabllot elektrike, kanalet e ujërave, etj. dhe është kolauduar se kjo zonë është e lirë nga instalimet nëntokësore.

7. NDIKIMET E IDENTIFIKUARA MJEDISORE DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E NDIKIMEVE

Gjatë fazës së ndërtimit të këtij projekti, mund të ketë ndikime në disa faktorë mjedisorë, ku ndikimi më i madh pritet të jetë gjenerimi i mbeturinave ndërtimore. Përveç kësaj, ndikime të rëndësishme mund të ndodhin edhe në cilësinë e ajrit, ujit dhe shkaktimin e zhurmës. Secili nga këta faktorë ka nevojë për vlerësim të kujdesshëm dhe masa të posaçme për minimizimin e ndikimeve negative.

Edhe gjatë kësaj faze disa efekte mjedisore janë kryesisht të përqendruara rreth hapësirës punuese. Faza e ndërtimit gjithashtu rezulton në degradimin e tokës, në krijimin e mbeturinave nga materialet ndërtimore, ndotjen lokale e ajrit, shkarkimin e ujërave nga procesi i punës, si dhe aspektet e sigurisë në punë, etj.

7.1 Ndikimet në cilësinë e ajrit

Gjatë ndërtimit të kompleksit shumë-banesor me afarizëm punë kryerësi do të kujdeset që kohë pas kohe të bëhet spërkatja e objekteve me ujë ne mënyre qe mos të kemi ndotje të ajrit me grimcat e pluhurit PM10. Gjithashtu makineria e rënd e cila do të përdorët gjatë ndërtimit do të jetë komfor rregulloreve në fuqi dhe emetimi i gazrave nga këto makineri do te jete sipas normave të lejuara. Pas përfundimit të kompleksit shumë-banesor me afarizëm nuk parashihet te këtë ndotje te ajrit, pasi qe në objekt nuk do të ketë aktivitete prodhuese.

Për të arritur nivelin e ajrit sa më të pastër gjithsesi duhet të kemi kontrollin permanent të kualitetit të ajrit në zonat ekonomike dhe banimit. Brenda kufirit të planit nuk mund të kemi destinime të cilat e ndotin mjedisin dhe e vështirësojnë funksionimin e zonës. Si masë e ruajtjes se ajrit është zhvillimi i rrjetit i transportit publik si dhe rrjetit të shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë, i cili do të ndikonte në shkarkimin e zonave te banimit nga trafikut intensiv.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes. 2023
PM2.5	26	18	12	9	8	8	7	10	8	8	10	30	12.92
CO	0.9	0.6	0.7	0.7	0.6	0.7	0.2	0.4	0.4	0.6	1	1.3	0.68

Tabela 1. Vlerat mesatare mujore të ajrit ne Prizren sipas raportit vjetor për gjendjes se ajrit 2023.

7.2 Ndikimet nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma e dëmshme për shëndetin e njeriut, është çdo zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendit ku buron zhurma, në mesin ku njerëzit punojnë dhe jetojnë. Gjatë ndërtimit të këtij dhe si rezultat i natyrës së punëve mund te vij edhe deri te ngritja e nivelit te zhurmës për mjedisin për rreth nga përdorimi i makinerive te ndërtimit siç janë vinçat, kamionët dhe mjetet e tjera te punës. Por duke marr parasysh që kjo zonë është mikës nivelet e lejuara janë më të larta.

Gjatë fazës së ndërtimit, zhurmat dhe vibrimet nga makineritë ndërtimore, transporti i materialeve dhe përpunimi i tokës mund të shkaktojnë shqetësime për komunitetin lokal, ndikime në shëndetin e punëtorëve dhe potencialisht dëmtime strukturore në ndërtesat përreth. Për të minimizuar këto ndikime, do të kufizohen oraret e punës në periudha të përshtatshme, do të përdoren pajisje moderne me izolim akustik dhe antivibrues, dhe do të vendosen barriera akustike rreth vendit të ndërtimit. Gjithashtu, do të kryhet monitorim i rregullt i niveleve të zhurmës dhe vibrimeve për të siguruar përputhjen me kufijtë e lejuar, ndërsa komuniteti do të informohet në kohë për aktivitete që mund të shkaktojnë shqetësime. Këto masa do të mbrojnë qetësinë dhe shëndetin e banorëve, duke reduktuar ndikimet negative në mjedis.

7.3 Ndikimet në peizazh

Gjatë ndërtimit dhe zgjerimit të Stadiumit "Përparim Thaqi," ndikimet në peizazh mund të jenë të konsiderueshme, duke përfshirë ndryshimin vizual të mjedisit përreth dhe ndikimet në integritetin estetik të zonës. Ndërtimi i strukturave të reja dhe zgjerimi i tribunave do të ndryshojë pamjen e përgjithshme të peizazhit urban dhe natyror, duke mundësuar një ndërhyrje domethënëse në harmoni me rrethinën. Aktivitetet ndërtimore, si gërmimet, lëvizja e materialeve dhe vendosja e infrastrukturës mbështetëse, mund të krijojnë përkohësisht një pamje të papërshtatshme dhe të ndikojnë negativisht në perceptimin vizual të zonës nga komuniteti lokal dhe vizitorët.

Për të minimizuar këto ndikime, projekti është konceptuar për të respektuar karakteristikat ekzistuese urbane dhe natyrore, duke harmonizuar ndërhyrjet arkitektonike me peizazhin përreth. Përdorimi i materialeve dhe formave që përputhen me kontekstin lokal do të ndihmojë në ruajtjen e estetikës së zonës. Gjithashtu, pas përfundimit të punimeve, do të kryhet rikuperimi i hapësirave të prekura përmes gjelbërimit, krijimit të hapësirave rekreative dhe përmirësimit të estetikës vizuale, duke siguruar që stadiumi të bëhet një pikë referimi që përmirëson peizazhin urban të Prizrenit.

7.4 Ndikimet në Ujërat Nëntokësore dhe Sipërfaqësorë:

Në afërsi të kësaj zone nuk ka ndonjë rrjedhje apo grumbullim të ujërave sipërfaqësor që do të mund të ndikoheshin nga ky projekt. Në anën tjetër niveli i ujërave nëntokësore, gjatë kohës me të reshura të larta atmosferike arrin deri afër sipërfaqes së tokës (1 deri 1,5 m nën sipërfaqen e tokës). Në momentin e mihjes, ujërat nëntokësor nuk janë takuar deri në thellësinë 2.5m, edhe pse hulumtimet u bënë gjatë sezonës me të reshura atmosferike. Gjatë punimeve makineria do të pastrohet brenda vend punishtes në mënyrë qe mos të vije të ndotja e rrugës gjatë qarkullimit.

Gjatë punimeve makineria do të pastrohet brenda vend punishtes në mënyrë qe mos të vije të ndotja e rrugës gjatë qarkullimit. Gjatë procesit të ndërtimit punë kryerësi do te përkujdesen qe uji i cili do te përdorët për nevojat e ndërtimi dhe për larjen e makinerive te largohet me cisterna dhe te mos derdhet ne vendin e ndërtimit. Derdhja e ujit të ndotur do te behet ne vendet e caktuara nga autoritetet përgjegjëse. Uji qe do të përdorët për nevojat gjate ndërtimit te objektit do te jete nga pusi (bunari) qe do të hapet për nevojat gjate ndërtimit.

Për ruajtjen e ujit me më rëndësi është ndërtimi i rrjetit të planifikuar për kanalizimin e ujërave të zeza. Ujërat e zezë duhen të derdhen në rrjetin e kanalizimit publik i cili ka impiantet për pastrimin e

ujërave të zezë. Rëndësi të veçantë duhet ti kushtetohet që të shfrytëzohen ujërat nëntokësorë, burimet qe mos të përdoret rrjeti I ujësjellësit të pijshëm në vend punishte.

7.5 Ndikimet në Florë dhe Faunë

Në kuadër të florës dhe faunës mund të flasim vetëm për zonat që kufizohen me këtë kompleks. Në këto zona rriten llojet me të zakonshme të florës dhe faunës. Në këtë zone nuk rriten dhe zhvillohen llojet e mbrojtura të florës dhe faunës. Zona përreth ku do të realizohet projekti është zonë e planifikuar dhe andaj nuk te këtë ndonjë ndryshim të madh. Gjithashtu kjo hapësirë nuk bene pjese ne njërën nga kategoritë e zonave te mbrojtura sipas ligjit te Natyrës.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin ku do të ndërtohet pjesa e re dhe në tërësi në këtë zonë nuk ekziston ndonjë ekosistem (pyll, livadh, kënetë, liqe etj.) apo diçka e ngjashme natyrore të cilat mund të rrezikohen me rastin e ndërtimit të objektit kolektiv me afarizëm.

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në aspektin e biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që ka potencial të futet nën mbrojtje. Meqenëse lokalitet ku parashikohet të ndërtohet kompleksi shumë-banesor me afarizëm, është zonë e pa zhvilluar në aspektin e biodiversitetit është shumë e varfër duke përfshirë florën dhe faunën.

7.6 Ndikimet në Vendbanime dhe Popullatë:

Ndikimet në vendbanime dhe popullatë mund të përfshijnë shqetësime për banorët lokalë dhe ndryshime në dinamikën sociale dhe ekonomike të zonës. Aktivitetet ndërtimore, si zhurmat nga makineritë, pluhuri dhe trafiku i shtuar, mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme për komunitetin. Përveç kësaj, lëvizja intensive e automjeteve ndërtimore dhe transporti i materialeve mund të krijojnë probleme në qarkullimin e rrugëve lokale dhe të ndikojnë në sigurinë e banorëve.

Nga ana tjetër, funksionimi i stadiumit pas përfundimit të ndërtimit do të ketë ndikime pozitive dhe negative. Ngjarjet sportive dhe aktivitetet e tjera mund të sjellin përfitime ekonomike për bizneset lokale, duke rritur turizmin dhe zhvillimin ekonomik të zonës, por gjithashtu mund të sjellin sfida, si grumbullimi i madh i njerëzve dhe presioni mbi infrastrukturën ekzistuese.

Për të minimizuar ndikimet negative dhe për të maksimizuar përfitimet, do të ndërmerren masa si: informimi dhe përfshirja e komunitetit në procesin e projektimit dhe ndërtimit, menaxhimi i trafikut për

të shmangur bllokimet dhe krijimi i rrugëve alternative, dhe kufizimi i aktiviteteve ndërtimore në orare të përshtatshme.

8. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE MJEDISORE

Masat për sajimin, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si dhe pjesëve të rrezikuara të tij do të zbatohen në harmoni me ligjet në fuqi si dhe me vendimet dhe udhëzimet qe janë relevante me këtë problematikë. Brenda zonës se planit nuk lejohet ndërtimi i objekteve qe potencialisht do të rrezikonin jetën dhe punën e qytetarëve, përkatësisht qe do të rrezikonin vlerat e përcaktuara sipas rregulloreve të posaçme për mbrojtjen e mjedisit të njeriut. Me këtë plan përcaktohen masat qe në zonën e planit duhet të arrihen për qëllim të sajimit, mbrojtjes dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit.

- zbatimi i masave për ruajtjen e ajrit,
- zbatimi i masave për ruajtjen e tokës,
- Zbatimi i masave për ruajtjen e ujit.
- Zbatimi i masave për mbrojtje nga zhurma

8.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të zvogëluar ndikimet negative në cilësinë e ajrit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të Stadiumit "Përparim Thaqi", janë planifikuar masa që përfshijnë lagien e rregullt të sipërfaqeve ndërtimore dhe transportimin e materialeve të mbuluara për të kufizuar pluhurin dhe grimcat e pezulluara. Makineritë dhe pajisjet ndërtimore do të mirëmbahen rregullisht dhe do të përdoren ato që plotësojnë standardet moderne të emetimeve, ndërsa trafiku ndërtimor do të organizohet për të reduktuar emetimet nga transporti. Për të monitoruar dhe kontrolluar ndotjen, do të instalohen stacione matëse dhe do të krijohen hapësira të gjelbëruara përreth stadiumit, që kontribuojnë në pastrimin e ajrit. Gjithashtu, do të kufizohet përdorimi i drurit për ngrohje në hapësirat ndihmëse, duke promovuar burime energjie më të pastra, dhe punimet ndërtimore do të kufizohen në orare të përcaktuara për të reduktuar ndikimet në komunitetin përreth. Këto masa synojnë mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e kushteve mjedisore.

8.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të zvogëluar ndikimet negative në ujë gjatë ndërtimit dhe funksionimit të Stadiumit "Përparim Thaqi", janë planifikuar masa gjithëpërfshirëse që përfshijnë lidhjen me rrjetin ekzistues të kanalizimit dhe instalimin e sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura. Sistemet për mbledhjen dhe filtrimin e ujërave të shiut do të sigurojnë ndalimin e materialeve ndotëse përpara shkarkimit, ndërsa hapësirat e gjelbra dhe bioretencat do të integrohen për pastrimin natyror të ujit. Për të parandaluar derdhjet aksidentale, materialet ndërtimore dhe makineritë do të menaxhohen me kujdes, dhe do të kryhen matje periodike të cilësisë së ujit për të garantuar përputhshmërinë me standardet mjedisore. Riciklimi i ujërave të shiut për ujitje dhe trajnimet për stafin do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e ndikimeve, duke siguruar mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore dhe të mjedisit përreth.

8.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të minimizuar ndikimet negative në tokë gjatë ndërtimit dhe funksionimit të Stadiumit "Përparim Thaqi," janë planifikuar masa si menaxhimi i mbetjeve ndërtimore përmes klasifikimit dhe riciklimit, ruajtja e kimikateve dhe karburanteve në depo të izoluara për të shmangur ndotjen, dhe kufizimi i lëvizjes së makinerive në zona të përcaktuara për të parandaluar dëmtimin e tokës. Pas përfundimit të punimeve, zonat e prekura do të rikuperohen me mbjellje bimësie për të rikthyer pjellorinë dhe strukturën e tokës, ndërsa do të vendosen masa për kontrollin e erozionit dhe monitorimin e cilësisë së tokës. Gjithashtu, përdorimi i materialeve ekologjike dhe instalimi i sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura do të kontribuojnë në ruajtjen e cilësisë së tokës dhe mbrojtjen afatgjatë të mjedisit përreth.

8.4 Masat për mbrojtje nga zhurma

Për të minimizuar ndikimin e zhurmës dhe për të siguruar që ajo të mbetet brenda vlerave të lejuara, janë parashikuar masa specifike që përfshijnë projektimin akustik të stadiumit, menaxhimin e niveleve të zhurmës gjatë ngjarjeve, menaxhimin e trafikut, monitorimin dhe kontrollin e zhurmës, si dhe informimin dhe edukimin e përdoruesve. Projektimi akustik do të përfshijë përdorimin e materialeve me izolim akustik për mbulesat dhe muret e tribunave, vendosjen e barrierave akustike rreth stadiumit në zonat e ndjeshme, dhe përdorimin e altoparlantëve të orientuar për të minimizuar përhapjen e zhurmës jashtë stadiumit. Menaxhimi i niveleve të zhurmës do të sigurohet përmes kufizimit të voluminizimit të altoparlantëve dhe pajisjeve muzikore, përcaktimit të orarit të përdorimit të stadiumit duke shmangur aktivitetet gjatë natës, si dhe rregullimit të përdorimit të pajisjeve akustike nga tifozët.

Për të reduktuar ndikimin nga trafiku, qasja dhe dalja nga stadiumi do të planifikohen në mënyrë që të minimizohet zhurma nga automjetet, ndërsa vendparkimet do të organizohen në zona të dedikuara larg ambienteve të ndjeshme. Monitorimi i rregullt i nivelit të zhurmës dhe përdorimi i sistemeve të avancuara për monitorimin gjatë ngjarjeve do të ndihmojnë në kontrollimin e ndotjes akustike, me ndërhyrje të shpejtë në rast të tejkalimit të kufijve të lejuar. Për më tepër, spektatorët dhe përdoruesit do të informohen mbi rëndësinë e respektimit të kufijve të zhurmës, ndërsa stafi do të edukohet për menaxhimin e saj dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara. Këto masa të integruara sigurojnë që ndikimi i zhurmës nga stadiumi të mbetet minimal, duke respektuar standardet dhe rregulloret ligjore në fuqi.




Figura 8. *Mbrojtja nga zhurma.*

Kur vjen puna te aspekti i argëtimit, kërkesat për sistemin e zërit në stadium janë më të larta. Kërkesat e mëposhtme janë tipike për UEFA EURO, Finalen e UEFA Champions League, Finalen e UEFA Europa League dhe UEFA SuperCup:

- **Sistemi i PA-së duhet të jetë i aftë për përdorim argëtues**, si sistem i integruar argëtimi ose si sistem argëtimi shtesë.
- **Qartësia e Zërit:** STI/RSTI prej 0,7/0,65 (matuar në një stadium të plotë)
- **Niveli i Presionit të Zërit:**

Dallimi në nivelin e presionit të zërit midis spektatorëve më të ekspozuar dhe më pak të ekspozuar ndaj altoparlantëve nuk duhet të kalojë 6dB SPL(A)


Niveli minimal i presionit të zërit është 110dB SPL(A) për 120 sekonda

- **Cilësia e Zërit:**

Gama e frekuencave: +/- 8dB në bandën 160Hz-12kHz

Sistemi duhet të jetë i lirë nga distorsioni, hişıma dhe humi

- **Zonat e Difuzionit:** Sistemi duhet të mbulojë të gjitha zonat e spektatorëve me mundësinë për të përjashtuar zonat e medias dhe fushën e lojës nga programi i argëtimit.



- *Figura 9. Në Kosovë mbi ndotjen akustike vepron ligji Nr. 02/L-102, i cili referuar standardeve të BE-së përcakton se norma e lejuar e zhurmës gjatë ditës është 55 decibel dhe gjatë natës 35 decibel.*[1]

8.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Për të minimizuar ndikimet negative të projektit në peizazh, florë dhe faunë, janë planifikuar masa gjithëpërfshirëse që përfshijnë ruajtjen dhe rikuperimin e hapësirave të gjelbra, mbrojtjen e bimësisë ekzistuese dhe rikthimin e habitatit të dëmtuar. Ndërhyrjet ndërtimore do të kufizohen në zonat e përcaktuara, ndërsa pemët dhe bimësia ekzistuese do të mbrohen me barriera mbrojtëse, duke siguruar mbjelljen kompensuese për çdo pemë të prerë. Niveli i zhurmës do të monitorohet dhe do të kufizohet për të mos shqetësuar faunën lokale, ndërsa orari i punimeve do të përshtatet për të shmangur periudhat kritike për kafshët. Gjithashtu, do të ndërmerren masa për të parandaluar ndotjen

[1] https://ecmandryshe.org/sq/lajmet/cka-eshte-ndotja-akustike

nga materialet ndërtimore dhe për të siguruar përdorimin e teknologjive të qëndrueshme që reduktojnë ndikimet negative në mjedis. Stafi ndërtimor do të trajnohet për të zbatuar praktikat e qëndrueshme, ndërsa komuniteti do të ndërgjegjësohet për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Monitorimi i rregullt dhe zbatimi i standardeve ligjore do të sigurojnë që stadiumi të ndërtohet duke respektuar biodiversitetin dhe harmoninë me peizazhin përreth.



Figura 10. *Llojet e gjelbërimit qe mund te vendosen ne kompleks pas përfundimit te ndërtimit.*

8.6 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Projekti arkitektonik është realizuar me forma të pastra gjeometrike dhe minimaliste, që i përshtaten volumit të madh të kërkuar nga funksioni i një stadiumi modern. Materialet e qëndrueshme të përdorura jo vetëm që i përgjigjen kërkesave funksionale dhe strukturore të ndërtesës, por gjithashtu sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë dhe integrim estetik me parkun dhe hapësirën urbane përreth.

8.7 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Për mbrojtjen nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore gjatë realizimit të projektit, është e domosdoshme hartimi i planit të intervenimit për aksidente mjedisore dhe mbrojtjen nga zjarri, përfshirë instalimin e pajisjeve zjarrfikëse dhe trajnimin e punonjësve. Pjesa e oborrit duhet të rrethohet me tel mbrojtës për të parandaluar hyrjen e paautorizuar, ndërsa duhet marrë masa për të shmangur derdhjet e derivateve të naftës dhe vajrave nga pajisjet transportuese dhe ngarkuese. Po ashtu, duhet garantuar siguri gjatë kyçjes së automjeteve në rrugët lokale dhe magjistrale, pa penguar komunikacionin, dhe të respektohen standardet për sigurinë dhe shëndetin në punë përmes pajisjeve mbrojtëse dhe trajnimeve për stafin. Monitorimi periodik, sinjalizimet e qarta, dhe zbatimi i masave mbrojtëse sipas legjislacionit në fuqi do të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të punonjësve, duke minimizuar rreziqet dhe aksidentet gjatë gjithë fazave të projektit.

8.8 Menaxhimi i mbeturinave

Si mbeturina të ngurta nga ky aktivitet llogariten mbetjet prej llojeve materiale të shfrytëzuara si dru, beton, copa tulle, qelqe, plastikë, metal, goma, stiropol si material biologjikisht i pa zbërthyeshëm etj. Kantiere të përkohshme që përdoren për punime ndërtimi dhe për strehim të punëtorëve të ndërtimit ekzistojnë në kuadër të bllokut dhe të njëjta do të modifikohen për këtë fazë kështu që efekti i tyre nuk është i theksuar. Mbeturinat komunale qe do të gjenerohen gjatë ndërtimit gjithashtu do të deponohen në kontejnerë adekuat dhe të njëjtat do të deponohen nga kompania publike në deponime sanitare

Pas përfundimit të punëve te zgjerimi, konsolidimit dhe rikonfigurmit përgjegjësia për deponimin e mbeturinave në vendin e duhur kalon tek shfrytëzuesit e objektit. Pasi kompleksi nuk ka destinim industrial mbeturinat e krijuara nuk kanë nevojë të kenë trajtim special.

Për mbetjet e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si më poshtë:

- Mbetjet e riciklueshme do të grumbullohen dhe do të dërgohen ose do të merren nga kompanitë që merren me riciklim.
- Mbetjet ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina.
- Mbetjet tjera eventuale, nëse krijohen, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin adekuat për menaxhimin e mbeturinave.

9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

9.1 Monitorimi

Është e qartë se aktivitetet e planifikuara për projektin e zgjerimit dhe rikonfigurimit të Stadiumit "Përparim Thaqi" nuk paraqesin trysni të rëndësishme mjedisore. Megjithatë, monitorimi i rregullt dhe i përhershëm i treguesve mjedisor është thelbësor për të siguruar që ndikimet e mundshme të mbahen nën kontroll.

- **Ndikimet në mjedis:** Duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujërave, zhurmën dhe menaxhimin e mbetjeve.
- **Veprimet e nevojshme:** Për çdo rast të ndonjë ndikimi negativ, duhet të ndërmerren masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të njoftohen organet kompetente për të siguruar zbatimin e masave korrigjuese.
- **Dokumentimi:** Të gjitha të dhënat nga procesi i monitorimit duhet të dokumentohen për të siguruar transparencën dhe për të ndihmuar në raportimin e mëvonshëm.

9.2 Raportimi

Raportimi i rregullt dhe i detajuar për monitorimin mjedisor do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i stadiumit ose nga ekspertët e përfshirë, si brenda ashtu edhe jashtë organizatës.

- **Përmbajtja e raportit:** Raporti duhet të përfshijë të dhënat mbi monitorimin e të gjithë parametrave mjedisorë të kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (dhe më pas në Lejen Mjedisore).
- **Procesi i raportimit:** Raportet duhet të përgatiten në intervale të rregullta (sipas përcaktimeve në Pëlqimin Mjedisor) dhe të dorëzohen tek autoritetet përkatëse, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).
- **Trajtimi i devijimeve:** Çdo devijim nga treguesit mjedisorë të përcaktuar në leje duhet të raportohet menjëherë dhe të shoqërohet me një plan veprimi për korrigjimin e situatës.

Të dhënat që do të raportohen përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Cilësinë e ajrit dhe ujit.

- Niveli i zhurmës.
- Menaxhimi i mbeturinave.
- Gjendjen e habitateve natyrore përreth.
- Masat e ndërmarra për minimizimin e ndikimeve mjedisore.

10. PËRFUNDIM

Në bazë të gjithë asaj që është thënë më lart, mund të konkludohet se ndikimet mjedisore nga zgjerimi dhe rikonfigurimi i stadiumit "Përparim Thaqi" nuk pritet të krijojnë ndonjë ndikim të patrajtueshëm në mjedis dhe në komunitetet lokale më të afërta. Ndikimet priten të jenë brenda nivelit të vlerave të rekomanduara nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme. Kjo do të thotë se zhvillimi i projektit dhe realizimi i kësaj veprimtarie në këtë lokacion është në interes të komunitetit lokal dhe qendror dhe është mjaft miqësor ndaj mjedisit.

Ndikimet mjedisore të përkohshme, si ndotja e ajrit, pluhuri dhe ndotja akustike gjatë fazës së ndërtimit, janë të menaxhueshme përmes zbatimit të masave të përshtatshme teknike dhe organizative. Gjithashtu, ndikimet në florën dhe faunën përreth minimizohen përmes rikuperimit dhe përmirësimit të hapësirave të gjelbra pas përfundimit të punimeve.

Implementimi i projektit siguron një strukturë sportive moderne që i përshtatet standardeve të UEFA-s dhe përmbush kërkesat e qytetit të Prizrenit për organizimin e eventeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky zhvillim përfaqëson një përfitim afatgjatë për komunitetin dhe ekonominë lokale, duke respektuar njëkohësisht detyrimet mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Rekomandohet që fazat e monitorimit të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit për të siguruar efektivitetin e masave të ndërmarra dhe ruajtjen e standardeve të përcaktuara.

Bazuar në këto të dhëna, mendojmë se raporti i VNM-së është i plotë dhe i mjaftueshëm për vlerësim. Si përfundim, propozojmë që institucioni kompetent, përkatësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të japë një mendim pozitiv për Pëlqimin Mjedisor, sipas kërkesës së investitorit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).

11. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE

REKAPITULIMI I PERGJITHESHEM

Rikonfigurimi-Zgjerimi i Stadiumit "Përparim Thaqi" në Prizren, Kategori II plus, sipas UEFA

nr	Pershkrimi/	€/Total
1	ARKITEKTURA DHE STRUKTURA	8,567,781.00 €
2	HIDROINSTALIMET	651,523.00 €
3	ELEKTRIKA	2,797,159.88 €
4	MAKINERIA	263,966.50 €
5	PUNËT NDËRTIMORE TE OBORRIT	564,290.00 €
	TOTALI I PERGJITHËSHEM :	12,844,720.38 €

Shënim: "Parapërllogaritja e Stadiumit është realizuar në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike, në pajtim me kërkesat e UEFA-s për kategorinë II plus, duke u bazuar në çmimet aktuale të tregut në vend"

12. LITERATURA

a) PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË PRIZRENIT 2013-2025: https://www.online-transparency.org/repository/docs/Plani_Zhvillimor_i_Komunes_se_Prizrenit_2013-20251.pdf
b) UEFA GUIDE TO QUALITY STADIUMS: https://editorial.uefa.com/resources/01f9-0f842793b513-3ec14e88e0ef-1000/uefa_guide_to_quality_stadiums.pdf
c) RAPORTI VJETOR PËR GJENDJEN E AJRIT 2023: https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20%20vjetor%20per%20cilesi%20te%20ajrti%202023%20-final%20alb.pdf
d) RAPORT VJETOR Për Gjendjen e Mjedisit 2022: https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20mjedisit%202022%20drafti%20final%20alb%20-%20Finale.pdf
e) https://ecmandryshe.org/sq/lajmet/cka-eshte-ndotja-akustike
f) Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, /03/L-025
g) Ligji për Mbeturinat, 02/L-30
h) Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, 08/L-025
i) Ligji për Mbrojtjen e Bimëve, 04/L-120
j) Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, 03/L-233
k) Ligji për Mbrojtjen nga zhurma, 02/L-102
l) Dokumentacioni teknik nga projektuesi

13. Shtojcat

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813068-11810-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	**07-463-04/118428/26**
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.09.2026 - 13:50
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Prizren / Prizren / Prizren
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813068-11810-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	23958	07-942-05/19604/26	18.02.2026	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PRIZREN	0		18.02.2026	

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prizren

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-71813068-11810-0	Parcelë / Parcela / Parcel	23958



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1745

Punoi/Obradio/Created: Avdullah Krasniqi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 22.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 01:53:27